



Pranuar / Dorezuar Primijseno/Prodato Received/Delivery	05.10.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtetp. Prileg Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SHKIPRIEK	6408/2023		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr.1060/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë; me Sabile Avdyli, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.Nr.1060/2023, të datës 07.08.2023, të parashtruar nga ankuesja [redacted] në çështjen juridike „masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.10.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.Nr.1060/2023, e datës 07.08.2023, e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. **Mbetet në fuqi** Vendimi me numër KA.Nr.25/2023, i datës 20.07.2023, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile [redacted] (tutje vetëm ankuesja), më datë 07.08.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjen A.nr.1060/2023, kundër Vendimit KA. Nr.25/2023, të datës 20.07.2023, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës si dhe kundër masës disiplinore „Vërejtje me shkrim” të datës 23.06.2023, me pretendim ankimor se vendimet e kundërshtuara janë të pabazuara ligjërisht.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli) në mbështetje të dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.08.2023,

ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa, ky i fundit, më datë 15.08.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë, së bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në autorizimet ligjore sipas nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 6153/2023, të datës 19.09.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1060/2023, të datës 07.08.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit se janë përmbushur kushtet për pranueshmerinë e ankesës sipas nenit 129 të LPPA-së, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5554/2023, të datës 07.08.2023, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me KA.Nr.25/2023, të datës 20.07.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Ankesën me Nr.A-135/23 të datës 26.06.2023 të parashtruar nga ankuesja në Komisionin e Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vërejtjen me shkrim me A.nr.135/2023 të datës 23.06.2023; email i datës 27.09.2023, nga F. Isufi për KPSHCK-në si provë shtesë së bashku me emailat: emaili i datës 27.09.2023 nga A. Zeqiri për KPSHCK, emaili i datës 27.09.2023, nga F. Isufi për KPMSHCK, emaili i datës 28.04.2023 nga R. Shasivari për F. Isufi, emaili i datës 27.09.2023 nga F. Iufi për KPMSHCK, emaili i datës 12.06.2023 nga E. Bajrami për F. Isufi, emaili i datës 12.06.2023 nga F. Isufi për ankuesen, emaili i datës 21.03.2023 nga F. Isufi për , kopje tekstit të sms me numrin 045 384 647, email i datës 01.02.2023 nga ankuesja për F.Isufi, email i datës 23.06.2023 nga ankuesja për F.Isufi, email i datës 23.06.2023 nga F. Isufi për ankuesen;; email i datës 01.02.2023 nga F. Isufi për ankuesen; Vendimin A.nr.773/2021 të datës 20.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 08.12.2022 nga F.Isufi për ankuesen; emailin e datës 12.06.2023 nga F.Isufi për ankuesen; emailin e datës 12.06.2023 nga F.Isufi për ankuesen; emailin e datës 23.06.2023 nga F.Isufi për ankuesen; e-mailin e datës 01.02.2023 nga F. Iufi për ankuesen; emaili i datës 01.02.2023 nga ankuesja për F.Isufi, emaili i datës 22.06.2023 nga ankuesja për F. Isufi; Diplomën universitare në emër të ankueses, me numër 2243 të datës 10.03.2014 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"- Fakulteti Juridik; Certifikatën me numër reference 03-15/119 të datës 30.06.2015 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"- Fakulteti Juridik për ankuesen;; si dhe shkresat e bashkangjitura: Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt emërimit me DBNJ/DPSKPK/901/2021 të datës 01.05.2021 të lëshuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës për ankuesen; dokumente mjekësor në emër të ankueses ng faqe numer 27 deri 50; përgjigje në ankesë më numër protokollit 1060 të datës 15.08.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të SKPK: Ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit me DBNJ/DPSKPK/1266/2022 të datës 01.11.2022; emailin e datës 11.08.2023 të dërguar nga B.L për S.GJ; E-mailin e datës 09.08.2023 të dërguar nga S.A për B.L; 3 Shkresa të dërguara me e-mail (nuk verifikohet të dhënat tjera për shkak të pamjes së paqartë); Vendimin me KA.Nr.10/2021 të protokolluar me numër 1090/2021 të datës 03.08.2021 të lëshuar nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vendimin KD.Nr.05/2021, të datës 06.07.2021, të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vendimin KD.Nr.05/2021 të datës 01.06.2021 të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; Vërejtjen më shkrim A.nr.234/2020 të datës

12.10.2020; Vërejtjen më shkrim A.nr.233/2020, të datës 12.10.2020; Vendimi VK/2023 me numër protokollit 6153/2023 i datës 19.09.2023 i Kryetarit të Këshillit për vazhdimin e afatit për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1060/2023, të datës 07.08.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizua shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankueses, *sepse:*

Nga shqyrtimi i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur së ankuesja është e punësuar në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës (SKPK) dhe së e njëjta sipas Ndryshim dhe Plotësim të Aktit të Emërimit DBNJ/DPSKPK/1266/2022, të datës 01.11.2022, ushtron pozitën e punës “Zyrtar Ligjor” në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Administratorja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, në cilësinë e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankueses, përmes parashtrësës me numër Nr.A-135/23, të datës 23.06.2023, ka shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore “vërejtje me shkrim”, me arsyetimin se kjo masë shqiptohet me qëllim të parandalimit të sjelljes të parregullt gjatë kohës së punës me prokuroret, duke e cilësuar veprimet e ankueses si shkelje disiplinore sipas nenit 4, pika 1, nën pika 1.1 dhe nenit 5, pika 1.5 dhe 1.7 të Rregullores Nr.04/11 për Procedurat Disiplinore në Shërbyesit Civil.

Ankuesja kundër masës disiplinore të datës 23.06.2023, parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa, ky i fundit, me Vendimin KA.Nr.25 /2023, të datës 20.07.2023, ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar, duke lënë në fuqi masën disiplinore “Vërejtje me shkrim” të datës 23.06.2023.

Ankuesja brenda afatit ligjor, parashtron në ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, duke kundërshtuar ligjshmërinë e Vendimit KA.Nr.25/2023, të datës 20.07.2023, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së dhe të masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” të datës 23.06.2023, me pretendim ankimor se vendimet e kundërshtuara janë të pabazuara ligjërisht. Shton se, administratorja ka qenë e njoftuar për gjendjen shëndetësore të ankueses dhe së pa vullnetin dhe dëshirën e saj është bërë transferimi të zyrat e disa prokuroreve. Tutje, thekson së Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka vendosur në mënyrë paushalle, vetëm duke u bazuar në arsyetimin e shkresës se administratores për shqiptimin e masës disiplinore vërejtje, dhe si i tillë është diskriminues, i pa mbështetur në prova dhe fakte. Propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të anulohet masa disiplinore “vërejtje” e shqiptuar me datë 23.06.2023.

Në kontest të themelësisë së pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenit 63 paragrafi 1, me të cilin përcaktohet se: “1.Nëpunësit civilë do t'u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, sikur që është përcaktuar me këtë ligj...” Nenit 64: “1. Nëpunësit civilë janë përgjegjës për çfarëdo shkelje të parimeve të përcaktuara sipas këtij ligji. 3. Nëpunësit civilë të cilët tregojnë pakujdesi të rëndë në respektimin dhe zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore të shërbimit civil, do t'u nënshtrohen masave disiplinore”.

Po ashtu Kolegji me rastin e vendosjes lidhur me këtë çështje juridike administrative, mori parasysh edhe dispozitat e Rregullores Nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, gjegjësitë nën 4 ku përcaktohet se : 4. "Shkeljet e detyrave të punës ndahen në: 1.shkelje të lehta dhe 2.shkelje të rënda serioze" si dhe nën 5 ku parashihet se: " 1. Shkelje të lehta disiplinore konsiderohen: 1.1 shkeljet e Kodit të Etikës së nëpunësit civilë; 1.2 mos mbajtja e kartelës identifikuese; 1.3 dy mungesa të paarsyeshme me kohëzgjatje njëditore brenda viti kalendarik; 1.4 mos respektimi i normave për veshjen dhe paraqitjen, 1.5. mos mbajtja në mënyrë të rregullt të shkresave dhe të të dhënave zyrtare që ndërlidhen me detyrat e punës, 1.6. mos respektimi i orarit të punës dhe 1.7 mos informimi për mungesën në punë".

Kolegji në vështirësi të dispozitave si me lartë, ka analizuar aktet e kundërshtuara me ankesë në ndërlidhje me provat materiale të çështjes, dhe si rrjedhojë konstatoi se Vendimi nën shenjë KA.Nr.25/2023, të datës 20.07.2023, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, bazohet në vërtetim të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të drejtë të dispozitave materiale, ngase sipas shkresave të lëndës rezultoi se brenda periudhës shkurt-qershor 2023, tri nga prokuroret e shtetit kur ankuesja ishte e sistemuar kishin kërkuar largimin e ankueses, mbi bazën se e njëjta nuk arrin të përmbush detyrat e saj të punës. Rrejdhimisht, sipas emailit të datës 01.02.2023 ankuesja kishte kërkuar që të largohet nga zyra e prokurores Besa Limani me arsyen se nuk është në gjendje të përballoj punën në këtë zyrë për shkak të kujdestarive të shpeshta dhe shëndetit të saj, ndërsa, prokuroreja Besa Limani përmes emailit të datës 21.03.2023, kishte parashtruar kërkesë pranë Administratores së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, për ndërrimin e ankueses, mbi bazën se e njëjta në vazhdimësi ankohet se ka shumë punë dhe nuk mund të punoj jashtë orarit të punës, duke vlerësuar se këto sjelle të ankueses e kanë penguar edhe në realizimin e punëve të përditshme. Me tej, ankuesja, është sistemuar në zyrën e prokurores Rukije Shasive, e cila me datë 28.04.2023 ka kërkuar largimin e ankueses për shkak se ankuesja nuk arrin të përmbush të gjitha punët zyrtare që i takojnë, duke sqaruar se ka një numër të madh të lëndëve që ka mbetur prapa në mungesë të një zyrtari ligjor efikas. Tutje, ankuesja është caktuar që të punoj tek prokuroreja Elza Bajrami, mirëpo, edhe kjo e fundit, përmes emailit të datës 12.06.2023, ka kërkuar zëvendësimin e ankueses, nga fakti se ankuesja nuk përshtatet me vëllimin e punës, është e ngadalshme në realizimin e detyrave të saj si dhe ka gabime të përsëritura.

Nisur nga gjendja e fakteve si me sipër, Kolegji vlerëson se mos ushtrimi i detyrave të punës nga ankuesja për pozitën e saj si zyrtare ligjore, janë veprime të cilat bien ndesh me detyrimet e përcaktuar me nenin 51 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku thuhet se : " Nëpunësit civilë i ushtrojnë detyrat e tyre në bazë të kushteve të përcaktuara me ligj dhe në përshkrimin e detyrave të punës në mënyrë të saktë, të ndërgjegjshme, të rregullt, në kohë dhe pa interes vetjak, në përputhje me interesin publik dhe në përputhje me sistemin juridik të Republikës së Kosovës. 2. Nëpunësit civilë janë të obliguar që të mbështesin dhe të lehtësojnë zbatimin e politikave të miratuara nga administrata publike. 3. Nëpunësit civilë duhet të veprojnë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe veprimet e tyre duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike..."

Po ashtu, Kolegji lidhur me pretendimin ankimor të ankueses së e njëjta është e sëmur dhe shëndeti i saj i pamundëson punën e kujdestarisë-jashtë orarit, Kolegji nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit i ka ofruar të njëjtës një pozitë tjetër të punës, por që ankuesja ka refuzuar



si të tillë, andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave, Kolegji i Këshillit konstaton se Administratorja e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, si mbikëqyrëse e drejtpërdrejt e ankueses ka cilësuar drejtë veprimet e ankueses si shkelje të lehtë disiplinore dhe ka shqiptuar masë disiplinore në proporcion me shkeljen disiplinore, duke vepruar në pajtim me nenin 66, paragrafi 1, të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar se *“1.Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuar nga sjellja e nëpunësit civil...”*

Theksuar si më lartë, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativë, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1060/2023

Sabile Avdyli

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të SKPK-së;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të SKPK-së; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

